

Kopje e gjedh me origjinalin

Dr. A. Muhametaj

Sek. Përgjithshme

A. Bylykbashi

FORMULARI I KONTRATËS

Titulli i Kontratës Mbikqyrja e punimeve për : “Rikualifikimin urban i Parkut Qendror Rinia”.

Kjo Kontratë është lidhur më datë 07.08.2017, midis **Bashkise Elbasan**, tani e tutje të referuar si “**Autoriteti Kontraktor**” dhe operatorit ekonomik, “**Taulant**” sh.p.k. me administrator (perfaqesues ligjor) te shoqerise znj. **Ditika Qatipi** tani e tutje i quajtur si **Mbikqyresi i Punimeve** ose “**Kontraktuesi**”.

Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor paraqet një kërkesë për kryerjen e shërbimeve, duke iu referuar Prokurimit nr.

Menjëherë pasi Kontraktori, me anë të ofertës së tij, me datë **16.08.2017** bie dakord të realizojë Shërbimet, ashtu siç janë të specifikuara në kushtet e përcaktuara në:


- Këtë Formular Kontrate
- Formularin e Deklarimit te Ofertës, të paraqitur nga Ofertuesi
- Përshkrimin e Kërkesës për Kualifikim
- Specifikimet Teknike
- Formulari i çmimit të ofertës
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Kushtet e Veçanta të Kontratës
- Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor
- Formularin e Sigurimit të Kontratës

Të gjitha këto dokumenta të bashkangjitur përbëjnë pjesë integrale të kësaj Kontrate. Menjëherë pasi Autoriteti Kontraktor pranon Ofertën nga Kontraktori, në një shumë prej **2.715.256,8** (dymilion e shtatëqind e pesëmbëdhjetëmijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë presje tetë) **lekë** (me tvsh) për kryerjen e shërbimeve,

Palët bien dakord si më poshtë:

1. Kontraktuesi duhet të paraqesë një Sigurim Kontrate në shumën prej: **271.526** (dyqind e shtatëdhjete e njëmije e peseqind e njetete e gjashte) **leke** dhe në formën e Depozites Bankare/Certifikates se Garancise, në ose përpara datës së shprehur në Njoftimin e Fituesit.
2. Kontraktuesi është i detyruar të furnizojë për Autoritetin Kontraktor, siç kërkohet në këtë Kontratë.
3. Autoriteti Kontraktor është i detyruar të paguajë për shërbimet e kryera, në shumën e parashikuar në këtë Kontratë.
4. Në këtë Formular Kontrate, fjalët dhe shprehjet do të kenë të njëjtin kuptim që i ngarkohet atyre në Kushtet e Kontratës.
5. Palët e kësaj Kontrate kanë përgjegjësi për moszbatim ose zbatim të papërshtatshëm të detyrimeve të tyre kontraktore dhe për dëmet e shkaktuara secilës nga moszbatimi i detyrimeve, që janë subjekt kompensimi, në përputhje me Kushtet e Kontratës.

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Qemal Stafa", Tel. +355 54 400152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al www.elbasani.gov.al




Sot, më datë 7.12.2017 palët bien dakort për nënshkrimin e këtij Formulari Kontrate.

PER AUTORITETIN KONTRAKTOR
BASHKIA ELBASAN
KRYETARI
Qazim Sejдини

PER KONTRAKTUESIN
“Taulant” sh.p.k
ADMINISTRATORI
Ditika Qatipi
Perfaqesuar me prokure
nr.2571 Rep nr.810 Kol
date 27.12.2016

Me Urdher dhe Porosi
Zv/ KRYETARI
Ervin Saraçi



Ervin Saraçi
Ditika Qatipi



Kopje e kësaj me origjinalin

Dr. A. Puhanezaj

Sek. Përgjithshme

A. Bylykbasiri



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA ELBASAN

KONTRATE PUBLIKE PER SHERBIME

**Mbikqyrja e punimeve për : “Rikualifikimin urban i
Parkut Qendror Rinia”**

E lidhur sot ne date 07.09.2017 ne Bashkine Elbasan, mbeshtetur ne vullnetin e lire te paleve, bazuar ne dispozitat e Kodit Civil, ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 58, ligjin 8402, date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit“, i nryshuar dhe U.K.M. nr.3, date 15.02.2001 “Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit“, i ndryshuar, midis:

Bashkise Elbasan, perfaqesuar nga Kryetari **z.Qazim SEJDINI**, njohur me poshte si **"Autoriteti Kontraktor"**,

Dhe

Shoqerise “Taulant” sh.p.k., e paisur me licencen perkatese me **nr. MK 0919/8 datë 19.04.2016** “Per mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi“, e percaktuar me poshte si **“Mbikqyresi i Punimeve” ose Kontraktori**, me seli Njësia Bashkiake nr.5, Rruga "Gjik Kuqali", pallati nr.23/2, shkalla nr.1, apartamenti nr.1, kati I-rë, Tiranë, regjistruar si person juridik me vendimin e Gjykates Rrethit Gjyqesor Tirane, nr.34575 date 20.12.2005, me Nipt K 61617040 L, me perfaqesues ligjor **znj.Ditika Qatipi**, e cila perfaqeson kete subjekt ne detyrimet e kesaj kontrate.

KREU I: KUSHTET E VEÇANTA TE KONTRATES
Shërbimet

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Ne rast se ka mosperputhje midis KPK dhe KVK do te mbizoterojne ato te Kushteve te veçanta te kontrates.

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. “Qemal Stafa”, Tel. +355 54 400152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al www.elbasani.gov.al



Neni 1: Objekti i kontrates

Objekti i kesaj kontrate eshte mbikqyrja e punimeve te zbatimit ne objektin **Mbikqyrja e punimeve për : “Rikualifikimin urban i Parkut Qendror Rinia”**.

Neni 2: Vlefte Kontrates

Vlera totale e kontrates me objekt **Mbikqyrja e punimeve për : “Rikualifikimin urban i Parkut Qendror Rinia”**, sipas ofertes se paraqitur ne tenderin e dates **16.08.2017** nga operatori ekonomik fitues, **“Taulant” sh.p.k** eshte **2.715.256,8** (dymilion e shtatëqind e pesëmbëdhjetëmijë e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë presje tetë) **lekë** (me tvsh).

Çmimi i parashikuar me siper perfshin te gjitha shpenzimet e kontraktuesit per sherbimin ne fjale, si dhe te gjitha detyrimet fiskale ne fuqi.

Neni 3: Kushtet e Pagesës.

Pagesa për Shërbimet duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm:

Pagesa e cmimit te kesaj kontrate do te behet nga Autoriteti Kontraktor ne monedhen **leke** nepermjet bankes _____, ne llogarine e Kontraktuesit nr. _____.

Pagesa do ti behet Kontraktuesit ne baze te perqindjes se situacioneve qe do te paraqiten per likuidim nga ana e shoqerise zbatuese te objektit, brenda 30 (tridhjetë) diteve nga paraqitja e tyre (situacioneve).

Data e pagesës do të jetë dita që fondet debitoohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor. Kur data e mesiperme eshte dite pushimi zyrtar, pagesa do te behet ditën pasardhese te punes. Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

Neni 4: Afati i Kontrates

Afati i kryerjes se sherbimit, objekt kontrate, nga Kontraktuesi do te jete **15 muaj** nga data qe do te lidhet kontrata e siper marrjes midis Bashkise Elbasan dhe subjektit zbatues.

Neni 5: Vendndodhja e Shërbimeve

Kontraktuesi do te kryerje sherbimin e mbikqyrjes ne objektin **Mbikqyrja e punimeve për : “Rikualifikimin urban i Parkut Qendror Rinia”** me vendndodhje Parku qendror Rinia qe gjendet ne lindje te qytetit te Elbasanit dhe ne veri te rruges nacionale Elbasan – Korce.



Kopje e kopyt me origjinalin
Dr. A. Puhanezaj

Sek. Pergjithshme

A. Bylykbashi

Neni 6: Sigurimi i kontrates

Kontraktuesi per realizimin e detyrimit te tij ne kete kontrate detyrohet te paraqese sigurimin e kontrates, ne formen e Garancise Bankare ose Certifikates se Garancise ne Shoqerite e Sigurimeve, per permbushjen e detyrimeve te kontrates, ne masen 10% te vleres totale te kontrates, ose ne vlere absolute 271.526 (dyqind e shtatedhete e njemije e peseqind e njezete e gjashte) leke.

Autoriteti Kontraktor do te beje clirimin e garancise se kontrates brenda 30 diteve pas kolaudimit dhe marrjes ne dorezim te punimeve.


Shuma e sigurimit te kontrates do ti paguhet Autoritetit Kontraktor si kompesim per cdo humbje te rezultuar nga deshtimi i Kontraktuesit ne plotesimin e detyrimeve te tij sipas kontrates. Nuk parashikohet zbritje periodike te garancisë së kontratës.

Neni 7: Te drejtat dhe Detyrimet e Paleve


Palet bien dakort per kushtet qe vijojne:

1. Mbikqyresi i punimeve nuk duhet te jete i lidhur ne asnje menyre me zbatimin e objektit qe do te drejtoje.
2. Menjehere me lidhjen e kontrates autoriteti kontraktor i dorezon mbikqyresit te punimeve informacionin dhe dokumentat e objektit per te cilin eshte ngarkuar te kryeje mbikqyrjen.
3. Mbikqyresi i punimeve do te vihet ne dijeni nga Autoriteti Kontraktor per nenkontraktoret e mundshem qe zgjedh subjekti zbatues, ne perputhje me kontraten e nenshkruar.
4. Mbikqyresi i punimeve, pervec sherbimeve te kontrollit per zbatimin e punimeve, duhet te ndjek edhe grafikun e punimeve.
5. Per objektin qe ndertohet, mbikqyresi i punimeve mban dhe pergjigjet per dokumentacionin e meposhtem :
 - Lejen e ndertimit, së bashku me vendimet përkatëse të lëshuara nga organi, i cili e ka këtë të drejtë;
 - Projektzbatimin e firmosur nga projektuesit;
 - Ndryshimet në projekt (nëse ka) dhe miratimin e tyre;
 - Planorganizimin e punimeve te ndertimit;

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Oemal Stafa", Tel. +355 54 400152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al



6. Mbikqyresi i punimeve eshte i detyruar te kontrolloje periodikisht, dhe ne fazat me kryesore, librin e kantierit dhe eshte pergjegjes per sakesine dhe vertetesine e dokumentave qe pasqyrohen ne te si dhe cilesine e punimeve te ndertimit.
7. Ne çastin e fillimit te punimeve, mbikqyresi i punimeve duhet te beje verifikimet paraprake si meposhte:
- Verifikimin e te gjitha dokumentacionit perkates, te licencave, te autorizimeve dhe te lejeve, te cilat, sipas dispozitave ne fuqi, duhet te merren para fillimit të punimeve;
 - Verifikimin e sheshit te ndertimit, nese eshte i lire dhe i gatshem per te filluar punimet;
 - Njohjen me hollesi te kontrates se siper marrjes lidhur midis autoritetit kontraktor dhe subjektit zbatues si dhe te gjitha akteve administrative qe lidhen me te, si dhe njohjen e te gjitha ndryshimeve te mundshme te kesaj kontrate me kalimin e kohes;
 - Vendorsjen e tabelës se identifikimit me te dhenat e meposhtme:
 - a) Emertimi i objektit;
 - b) Data e marrjes se lejes se ndertimit;
 - c) Investitori;
 - d) Projektuesi;
 - e) Subjekti zbatues dhe drejtuesi teknik;
 - f) Mbikqyresi;
 - g) Afati i ndertimit;
 - h) Siperfaqja e ndertimit;
8. Mbikqyresi i punimeve, pas verifikimeve te percaktuara ne piken 9 (pjesa e I) te U.K.M. nr.3 dt.15.02.2001, te ndryshuar, duhet te hartoje dokumentacionin e meposhtem:
- Aktin e dorezimit te sheshit te ndertimit shoqerise sipermarrese;
 - Aktin e dorezimit nga subjekti zbatues te dokumentacionit teknik dhe administrativ, si licenca, autorizime e leje te marra nga subjekti zbatues;
 - Shkresen me ane te se ciles njofton Autoritetin Kontraktor per fillimin e punimeve;
9. Mbikqyresi i punimeve, gjate zbatimit te objektit, i jep instruksione dhe urdhera, me shkrim, subjektit zbatues sa here qe e shoh te nevojshme, ne zbatim te akteve ligjore e nenligjore dhe ky i fundit eshte i detyruar t'i respektojte ato, por duke ruajtur te drejten t'i beje me shkrim Autoritetit Kontraktues verejtjet e tij, per instruksionet dhe urdherat e mbikqyresit te punimeve.




Kopje e kësaj me origjinalin

Dr. A. Rukamedaj

Sek. Përgjithmë

A. Bylykbashi

10. Mbikqyesi i punimeve ka te drejte te propozoje largimin nga puna te nje ose te disa personave nga personeli i subjektit zbatues. Per te realizuar kete, ai i drejtohet me shkrim titullarit te shoqerise zbatuese, duke i shpjeguar arsyet. Arsyet kryesore te propozimit per largim mund te jene moszbatimi i standarteve dhe i rregullave teknike, mosbindja, paaftesia, arbitrariteti ne zgjidhjen e problemeve teknike ose pakujdesi te renda.
11. Materialet qe vijne ne kantier duhet te jene ne perputhje me kerkesat teknike te projektit. Materialet ne veper perdoren vetem me miratimin e mbikqyresit te punimeve. Materialet e ardhura, si dhe pajisjet e siguruara nga subjekti zbatues, por qe nuk pranohen nga mbikqyesi, zevendesohen me te tjera, me shpenzimet e subjektit zbatues. Ne keto raste (si per materialet, ashtu dhe per pajisjet) mospranimi duhet dokumentuar me procesverbalet e analizave te provave, se bashku me aktin teknik, ku te argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standarteve te detyrueshme shqiptare ose atyre europiane.
12. Mbikqyesi i punimeve ka te drejte te kerkoje kryerjen e provave te materialeve te vendosura ne objekt, kur keto nuk jane kryer ne masen, sipas vellimeve te realizuara dhe pjeses se lendes se pare te furnizuar, per te verifikuar cilesine. Shpenzimet per keto prova jane ne ngarkim te subjektit zbatues.
13. Kur mbikqyesi i punimeve mendon se ka defekte ne zbatimin e punimeve, kerkon verifikimet perkatese. Kur verifikimet i japin te drejte mbikqyresit te punimeve, shpenzimet jane ne ngarkim te subjektit zbatues. Ne rast te kundert, subjekti zbatues ka te drejte te kerkoje shlyerjen e shpenzimeve.
14. Mbikqyesi i punimeve ka te drejte te pezulloje, perkohesisht, punimet per zbatimin teknik te gabuar ose paaftesi teknike zbatimi, ne çdo rast me miratimin e Autoritetit Kontraktues per aq kohe sa quhet e nevojshme korrigjimi i gjendjes.
15. Mbikqyesi i punimeve duhet te kontrolloje zbatimin e grafikut te hollesishem te punimeve dhe ti raportoje çdo 10 dite Autoritetit Kontraktues per realizimin e tij. Asnje punim nuk do te mbulohet, maskohet a betonohet pa miratimin e mbikqyresit te punimeve. Subjekti zbatues duhet te njoftoje mbikqyresin kur punimet jane gati per tu ekzaminuar prej tij.



16. Mbikqyresi i punimeve mban dosjen e mbikqyrjes se punimeve, ku pasqyrohen te gjitha aktet e mbajtura gjate zbatimit te objektit, qe nga akti i dorezimit *te sheshit te ndertimit*, urdherat e ndryshme qe ai ka dhene gjate zbatimit te objektit, kundershite dhe kontradiktat te lindura gjate punes, nderprerjet e punimeve dhe shkaqet qe kane diktuar keto nderprerje, relacionet teknike, te kerkuara ose te paraqitura gjate zbatimit, si dhe te gjitha rrethanat e nevojshme per te dhene kuadrin e plote te te gjitha fazave te zbatimit te punimeve. Kete informacion te detajuar mbikqyresi i punimeve eshte i detyruar t'ja raportoje Autoritetit Kontraktues.

17. Ne rastin e nderrimit te mbikqyresit te punimeve, mbahet procesverbali i dorezimit te dosjes se punimeve, ku shenohen edhe shkaqet e ketij nderrimi. Dokumentacioni i mbikqyresit te vjeter i dorezohet mbikqyresit te ri. Autoriteti Kontraktues mund te kerkoje largimin dhe zevendesimin e mbikqyresit, kur vertetohen mangesi serioze ne veprimtarine e tij, si:

- *Mangesi ne plotesimin e detyrave te percaktuara ne piken 1 te U.K.M. nr.3 dt.15.02.2001, te ndryshuar;*
- *Nderprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre;*
- *Mangesi kontrolli ne kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlera mbi ato te preventivuara ose jo me cilesi;*

18. Me perfundimin e punimeve, brenda 30 diteve, mbikqyresi i punimeve duhet ti kerkoje me shkrim subjektin zbatues qe te paraqese:


- *Kontraten e sipermarrjes dhe aktet qe lidhen me te;*
- *Regjistrimin e kontabilitetit;*
- *Procesverbalet e fillimit, te nderprerjes ose te zgjatjes dhe te perfundimit te punimeve;*
- *Çertifikatat e provave te materialeve te perdorura, te leshuara nga labororet e autorizuar per kete qellim;*
- *Deklarate se objekti eshte ndertuar ne perputhje me projektin dhe me kushtet teknike;*

Per te gjitha problemet e verifikuara prej tij, mbikqyresi i punimeve duhet te firmose gjithçka qe ka miratuar. Ai mban pergjegjesi ligjore, se bashku me subjektin zbatues. Nje kopje e dokumentacionit, e miratuar nga mbikqyresi i punimeve, i dergohet kolaudatorit te objektit.



Kopje e kësaj me origjinalin
Dr. A. Rukandaj
Sht. Përgjithshme
A. Bylykbashi

19. Mbikqyesi i punimeve duhet të marrë pjesë në kolaudimin e vepres, i përgjigjet kolaudatorit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kolaudimin e vepres, si dhe firmos procesverbalin e këtij kolaudimi.
20. Situacionet e paraqitura nga subjekti zbatues, në fazat e ndryshme të punimeve kontrollohen dhe miratohen nga mbikqyesi i punimeve. Paga mund të kryhet vetëm në bazë të këtij miratimi. Këto dokumente dërgohen në sektorin financiar të punedhënesit, bashkë me vertetimin e perkohshëm të pagesës, për të shpallur vlerën e detyrueshme për pagim.
21. Pas përfundimit të kolaudimit, mbikqyesi i punimeve, mbeshtetur në kontratën dhe në dokumentacionin tjetër, përcakton vlerën përfundimtare të objektit, e cila i behet e ditur subjektit zbatues, si dhe i jepet për likuidim Autoritetit Kontraktues.
22. Mbikqyesi i punimeve duhet të kontrollojë dhe autorizojë përdorimin e fondit rezerve, të preventivuar, dhe të raportojë, periodikisht, Autoritetit Kontraktues për gjendjen e tij. Ky i fundit, nëse ka vërejtje, e njofton subjektin zbatues dhe problemin zgjidhet ndërmjet tyre. Për çdo ndryshim të mundshëm, mbikqyesi i punimeve do të vihet në dijeni, për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë.
23. Autoriteti Kontraktues nuk i bën pagesën mbikqyresit të punimeve nëse konstaton se nuk janë respektuar dispozitat ligjore dhe nenligjore për realizimin e kontratës dhe mbikqyrjes së punimeve.
24. Në përfundim të periudhës së garancisë, Autoritetit Kontraktues, kolaudatori, mbikqyesi dhe zbatuesi i punimeve duhet të bëjnë kontrollin përfundimtar të vepres. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtimit - montimit, Autoriteti Kontraktues llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.
25. Kur vërehen shkelje të rëndësishme të dispozitave ligjore, Autoriteti Kontraktues ose dikasteri nga varet ky Autoritet Kontraktues, si dhe inspektoriati ndërtimor e urbanistik vendor/kombëtar, kanë të drejtë të urdherojnë mbikqyresin e punimeve për ndërprerjen e punës, deri në marrjen e masave përkatëse, për normalizimin e gjendjes.
26. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbejnë kundërvajtje administrative, vendosen sanksione, në bazë të nenëve 15 dhe 16 të kreu III të ligjit nr.8402 dt.10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar.
27. Mbikqyesi i punimeve mban përgjegjësi ligjore për mosrespektim të kushteve të kësaj kontrate dhe akteve ligjore e nenligjore në fuqi.



Neni 8: Dispozita te fundit

Kontrata hyn ne fuqi ne momentin e nenskrimit te saj nga palet.

Mosmarreveshjet midis paleve do te zgjidhen me mirekuptim, ne rast te kundert per zgjidhjen e tyre palet do ti drejtohen Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan.

KUSHTET E PËRGJITHSHME


Shërbimet

Neni 1: Qellimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.



Kopje e njezërme origjinale
Dr. A. Rukamçaj
Sek. Përgjithshme
A. Bylykbashi

- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.



- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi është dakort që të përjashtojë veten e tij nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndertimeve që mund të pasojnë, si rezultat i, ose në lidhje me, këtë kontratë.
- 4.4 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.



Kopje e kopyzimit origjinalit
Dr. A. Puhanczaj
Sek- Përgjithshme
A. Bylykbashi

- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.


Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

- 7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithsi.
- 7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetences së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit

- 8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.
- 8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Qemal Stafa", Tel: +355 54 400152, E-mail: bashkia@elbasan.gov.al web: www.elbasani.gov.al



Neni 9 Specifikime dhe Skicime

- 9.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatiti të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranura dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marri parasysh standartet më të fundit.
- 9.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë pregatitur në bazë asnjane përsa i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

Neni 10 Lejet dhe Liçensat


- 10.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor

- 11.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në oferten e Kontraktuesit.
- 11.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.
- 11.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.
- 11.4 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkak i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.

Neni 12 Vendndodhja

- 12.1 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuara në kontratë.
- 12.2 Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet në mënyrë të paarsyeshme.



Kopje e kësaj me origjinalin
Dr. A. Ruzhicaj
Sek. Përgjithshme
A. Bylykbashi

Neni 13 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale


- 13.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.
- 13.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

Neni 14 Çmimi i Kontratës

- 14.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në oferten e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 15 Afatet e Pagesës

- 15.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.
- 15.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes së Shqipërisë në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.
- 15.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.
- 15.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.
- 15.5 Data e pagesës do të jete dita që fondet debitohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.



Neni 16 Vonesa në Bërjen e Pagesës

- 16.1 Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë, konsistojnë në kamaten që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përçindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.
- 16.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) të provojë ndonjë dem. Në se kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar një dëm me të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

Neni 17 Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

- 17.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 18 Forca Madhore

- 18.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontratës, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.
- 18.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 18.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.




Kopje e kësaj me origjinalin
Dr. A. Rukhancbegj
Sek. Përgjithshme
A. Bylykbashi

Neni 19 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

- 19.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 19.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.
- 19.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.
- 19.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.
- 19.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

Neni 20 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

- 20.1 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:
- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
 - Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.



- c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

Neni 21 Negociatat dhe Amendamentet

- 21.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.
- 21.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 21.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 22 Ndryshimi i Porosisë

- 22.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

Neni 23 Ndërprerja për Mosplotësim

- 23.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
- a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
 - b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
- 23.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.



Kopje e kërkesës me origjinalin
Dr. A. Rukhmedaj
Sek. Përgjithshme
A. Bylykbadri

Neni 24 Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

- 24.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.
- 24.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 25 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

- 25.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- 25.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.
- 25.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 26 Nënkontrata

- 26.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë
- 26.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësinë e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.
- 26.3 Cdo nënkontraktor duhet të ketë të drejte të marre pjese në prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.

Adresa: Bashkia Elbasan, Rr. "Qemal Stafa", Tel. +355 54 400152, E-mail bashkiaelbasan@elbasani.gov.al web: www.elbasani.gov.al



26.4 Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizoje një pjesë të punimeve me nënkontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kerkuar per nenkontraktuesin si dhe punimet konkrete qe do te jape me nensipermarrje.

26.5 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

Neni 27 Transferimi i të Drejtave

31.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

Neni 28 Sigurimi i Kontrates

28.1 Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për fitimin e kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japi Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e pranueshme siç specifikohet në kontratë. Deshtimi për të dhene sigurimin e kontrates në formën dhe në shumën e kërkuar brenda 30 ditëve do të rezultojë në anullimin e kontratës dhe konfiskimin e sigurimit të ofertes së Kontraktuesit.

28.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

28.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

Neni 29 Baza Ligjore

29.1 Kontrata do të qeveriset nga dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 30 Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

30.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

30.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.



Kopje e kësaj me origjinalin

Dr. A. Puharçaj

Seb. Përgjithshke

A. Bylykbashi

Neni 31 Përfaqesimi i Palëve

- 31.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.
- 31.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.
- 31.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 32 Lajmërimet

- 32.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.
- 32.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.


Neni 33 Llogaritja e Afateve

- 33.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

Kjo kontrate pasi u hartua, u lexua nga te dyja palet, te cilat i gjeten te drejta dispozitat e saj dhe e nenshkruan ate respektivisht.

Kjo kontrate u hartua ne tre kopje origjinale, dy prej te cilave merren nga Autoriteti Kontraktor dhe nje kopje nga kontraktuesi.

Kontrata firmoset dhe vulozet ne cdo flete nga te dyja palet.



PER AUTORITETIN KONTRAKTOR
BASHKIA ELBASAN
KRYETARI
Qazim Sejдини

Me Urdher dhe Porosi
Zv/ KRYETARI
Ervin Saraci



PER KONTRAKTUESIN
"Taulant" sh.p.k
ADMINISTRATORI
Ditika Qatipi
Perfaqesuar me prokure
nr.2571 Rep nr.810 Kol
date 27.12.2016
Eriona Qatipi



Konceptoi : G. Muça

Pranoi:Përgjegjës: A. Memetaj

Konfirmoj :Drejtori: A. Bylykbashi